



LAJME nga FONDACIONI
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË
Tiranë

N.24
Janar
2026

Redaksia "ZKM ALBANIA"
Kompleksi Spitalor Universitar
"Zoja e Këshillit të Mirë"
Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë

unikzkm
unikzkm
www.unizkm.al
pr@fzkm.org

SË PARI: TË MARRËSH PJESË

Një vit i ri
që nis mirë

Ka nisur aventura e vitit të ri 2026, e cila karakterizohet që në fillim nga disa nisma që konfirmojnë integrimin aktiv të Fondacionit "Zoja e Këshillit të Mirë" në realitetin shqiptar.

Të premten më datë 16 janar votuam për të zgjedhur "Të Drejtin" emri i të cilit do të gdhendet në një nga gurët "Kopshtin e të Drejtëve". Ky është i vetmi vend që i përfshin qytetarët përmes votimit në një angazhim qartësisht demokratik. Në këtë datë studentët, punonjësit e Fondacionit, miqtë dhe të gjithë të pranishmit në Kampus patën mundësinë të votonin. U shpërnda një broshurë me profilet e kandidatëve në mënyrë që votuesit të ishin të informuar dhe të ndërgjegjshëm para se të votonin.

Me anë të kësaj iniciative por dhe të tjerave fondacioni synon t'i bëjë ballë një mentaliteti që mbjell mungesë shprese dhe nxit mosbesim të vazhdueshëm. Ne besojmë në atë që ka shkruar **Papa Leoni XIV në mesazhin e tij për Ditën Botërore të Paqes më 1 janar** duke bërë thirrje për "zhvillimin e shoqërive civile të vetëdijshme, të formave të shoqatave të përgjegjshme, të përvojave të pjesëmarrjes paqësore". Le ta lexojmë të gjithë këtë mesazh dhe ta zbatojmë në vendet ku jetojmë, punojmë, studiojmë dhe kujdesemi për njëri-tjetrin.

Mesazhi është i disponueshëm në disa gjuhë: <https://www.vatican.va/content/leo-xiv/it/messages/peace/documents/20251208-messaggio-pace.html>

të mërkurën e 28 janarit kujtojmë njëzet vjetorin e Fakultetit të Farmacisë, i cili nisi në bashkëpunim me Universitetin e Milanos ndërsa sot zhvillohet në bashkëpunim me Universitetin e Barit.

Ky do të jetë një rast për të inauguruar dy laboratorë: laboratorin e Kimisë dhe Analizave Farmaceutike dhe laboratorin e Teknologjisë Farmaceutike, të cilët do t'i bashkohen laboratorit të Virologjisë Qelizore dhe Molekulare, i cili është realizuar në bashkëpunim me NATO-n. Në të njëjtën ditë **Fondacioni do të nënshkruajë një deklaratë mirëkuptimi me Spitalin "Bambino Gesù" të Romës**, një qendër ndërkombëtare e ekselencës për diagnostikimin dhe trajtimin e fëmijëve të sëmurë, shumë prej të cilëve vijnë nga Shqipëria dhe vendet e Ballkanit.

Në janar jemi ende në pritje të lejeve të ndërtimit nga ana e administratave publike për ndërtimin e strukturave të reja për aktivitete të kujdesit shëndetësor dhe universitar. Kjo pritje duhet thënë me sinqeritet që është zgjatur shumë duke pasur parasysh nevojat e dukshme që meritojnë më shumë vëmendje. Fondacioni vazhdon misionin e tij i mbështetur fort në natyrën e vet si një ent jofitimprurës (të ardhurat nga aktivitetet e tij shpërndahen tërësisht për qëllimet statutorë të Fondacionit) dhe gjithmonë i frymëzuar nga vlerat e solidaritetit dhe të dashurisë vëllazërore që burojnë nga identiteti i tij katolik në dialog të vazhdueshëm me të gjithë burrat dhe gratë me vullnet të mirë.

VOTIMI PËR TË DREJTIN, AKT QYTETAR DHE DEMOKRATIK

Çdo vit si një sfidë e re

Çdo vit i ri nis në Kampusin Spitalor dhe Universitar "Zoja e Këshillit të Mirë" me një ngjarje që rrënjët i ka tek edukimi dhe qytetaria dhe kjo ngjarje është zgjedhja e Të Drejtës të vitit.

Më 16 janar 2026 studentë, profesorë, të ftuar, miq dhe partnerë, pacientë e familjarë të tyre që u ndodhën në

lloji në Shqipëri krijuar falë iniciativës së Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë. Duetrokasim fort të gjithë ata që u bënë pjesë e zgjedhjes së një prej kandidatëve në garë, duetrokasim të rinjtë tanë që na ndihmuan në këtë proces dhe ekipin mbështetës të UKZKM dhe FZKM që bëjnë të mundur organizimin e proceseve



Kampusin ZKM dhe në Poliambulancën At'Luigji Monti në Rugën e Kavajës votuan në mënyrë të fshehtë dhe demokratike për të zgjedhur mes kandidaturave profilin e njerëzve që kanë kontribuar me jetën dhe veprën e tyre për një botë më të mirë.

Jo vetëm votim, por edhe reflektim që nëpërmjet procesit të zgjedhjes së fshehtë rrit dimensionin qytetar të të rinjve dhe u jep atyre përgjegjësinë e qytetarëve të së ardhmes ku duhet të ketë folenë toleranca, dialogu, bashkëpunimi, vullnetarizmi dhe ndihma për më të dobët.

Shumë të rinj u angazhuan në këtë proces unik që ndodh vetëm në UKZKM dhe që kulmon këtë vit më 11 mars 2026 me gdhendjen e emrit të fituesit në një nga gurët e Kopshtit të Të Drejtëve, kopshtit të vetëm të këtij

qytetare. Zgjedhja e Të Drejtës organizohet për të tretin vit radhazi në UKZKM dhe ka nisur të hedhë rrënjët e një tradite të re që mbështet vendimin e Parlamentit Evropian që u ka kushtuar Të Drejtëve një ditë kujtese në kalendar.

Të Drejtët nderohen çdo 6 mars për kontributin që kanë dhënë në komunitete të ndryshme. Por këtë vit ceremonia jonë do të organizohet më datë 11 mars 2026 sepse në po këtë ditë do të shpallet edhe I Drejti i Kopshtit të ngjashëm me ne në Milano të Italisë.

Duke qenë se jehona e Kopshtit të UKZKM ka dalë jashtë kufijve të Shqipërisë vendosëm që Të Drejtën ta shpallim në të mëjtën ditë me qytetin e Milanos si shenjë e një rrjeti të madh që vlerëson kontributin njerëzor.

Falemiderit!
KOPSHTI
I TË DREJTËVE

TIRANË

Falenderojmë studentët që u angazhuan në qendrat e votimit:

Alessia Parrotta, Helena Çajupi, Thomas Çapi, Elia Lika, Mirko Pingitore, Samanta Shani, Lorenzo Bonazzi

Zgjedhja e Të Drejtës 2026 u krye me sukses në të gjithë hapësirën e Kampusit Ndërkombëtar Spitalor dhe Universitar Zoja e Këshillit të Mirë.

Dhjetra studentë, profesorë, të ftuar dhe partnerë të FZKM e jo vetëm hodhën votën për të mbështetur 5 kandidatët që ishin këtë vit si alternativë në fletën e votimit. Emri që do të mbledhë më shumë vota do të gdhendet në Kopshtin e Të Drejtëve. Kjo ishte një ditë e angazhuar për të gjithë duke realizuar për të dytin vit radhazi një proces informues dhe shumë qytetar.



Të gjithë ne, ashtu siç na mësojnë të Drejtët, mund të bëhemi kujdestarë të njerëzimit.

Për këtë arsye së bashku me historitë e të Drejtëve duhet të risjellim në vëmendje fjalë të rëndësishme për të ndërtuar një të ardhme plot shpresë si: demokracia, dialogu, përfshirja, pluraliteti, paqja, lufta ndaj dhunës. Prandaj ju falënderoj të gjithëve për punën tuaj të palodhshme nëpër këto Kopshte dhe në përhapjen e mesazhit të të Drejtëve.



Gabriele Nissim

Themelues dhe president i Gariwo Gardens of the Righteous Worldwide – Milano

PËRSE?



KOPSHTI I DREJTËVE

Kopshtet e të Drejtëve janë krijuar për të nderuar gratë dhe burrat, të cilët përballë mizorive masive marrin përgjegjësi personale për të mbrojtur dinjitetin njerëzor dhe për t' u ardhur në ndihmë viktimave. Këto hapësira kanë si qëllim t' u paraqesin si shembull opinionit publik ata njerëz që edhe duke rrezikuar jetën kanë qenë të aftë të shkojnë kundër rrymës dhe të ruajnë vlerat njerëzore përballë ligjeve të padrejta apo indiferencës së shoqërisë. Një I Drejtë vepron sepse dëgjon thirrjen e ndërgjegjes së tij, i do të tjerët dhe bukurinë e jetës. Për të festuar njëzet vjetorin e themelimit të Universitetit ZKM në vitin 2024 u inaugurua në Tiranë Kopshti i të Drejtëve, i vetmi në Shqipëri i kësaj natyre.

CILËT ISHIN KANDIDATËT?

1



FALKONE E BORSELINO

Jo mafias!

Falkone dhe Borsellino luftuan me përkushtim sublim realitetin e egër të mafies, realitetin e egër të Cosa Nostra-s që shtrihej me krimet dhe ndikimin e saj deri tek lidhjet me politikën, ekonominë apo grupimet e fshehta subversive.

Për shkak të kësaj lufte pa kompromis ata u vranë! Giovanni Falcone lindi në Palermo në vitin 1939. Paolo Borsellino lindi në të njëjtën lagje tetë muaj më vonë, në vitin 1940.

2



ANNALENA TONELLI

Ajo që ka rëndësi është dashuria

Prania e kësaj gruaje mes popullsisë myslimane në shkretëtirën e Kenias i mahniti të gjithë.

Nuk ishte e martuar dhe nuk i përkiste asnjë urdhri fetar. Annalena mbërriti në vitin 1970 në Wajir në kufirin me Somalinë mes nomadëve dhe qëndroi atje deri në vitin 1985.

Me ndihmën e shtetit dhe të miqve krijoi një qendër për personat me aftësi të kufizuara dhe për të sëmurët me tuberkuloz.

Ken Saro-Wiwa ishte romancier, poet dhe producent televiziv shumë i njohur me kombësi nigeriane. Ai udhëhoqi një lëvizje paqësore në mbrojtje të të drejtave të pakicës Ogoni që numëronte rreth gjysmë milioni njerëz pranë deltës së Nigerit që shfrytëzohej nga kompania shumëkombëshe e naftës Shell. Regjimi ushtarak e burgosi disa herë dhe pas shumë përplasjesh me sistemin u dënua me vdekje nga një gjykatë që ngriti një proces të nxituar dhe farsë. Pavarësisht protestave ndërkombëtare Saro-Wiwa u var më 10 nëntor 1995 së bashku me tetë aktivistë të tjerë, ishte vetëm 54 vjeç.

3



KEN SARO WIWA

.....
*Për tokën e tij,
popullin e tij
dhe mjedisin*

4



ANNA POLITKOVSKAJA

E vërteta do t'ju çlirojë

Anna Politkovskaja ishte e pamëshirshme ndaj të fuqishmëve të Avegjël apo të mëdhenj duke nisur nga Putin. Por ajo ishte plot dhembshuri njerëzore për viktimat, të pafajshmit e shtypur, të torturuar, të zhdukur, të vrarëap të harruar.

Një grua e madhe dhe simbol i gazetarisë së lirë që dinte të thoshte të vërtetat që e lëndonin pushtetin politik dhe që shumë qytetarëve nuk u pëlqente ti dëgjonin. Anna lindi në vitin 1958 në New York nga prindër ukrainas, ishdiplomatë sovjetikë dhe u kthye në Rusi ku u diplomua për gazetari. Shkroi për "Novaja Gazeta", gazetë e drejtuar nga Dmitrij Muratov (Çmimi Nobel për Paqen 2021).

Frère Roger, kalvinist zviceran dhe student i teologjisë u largua nga vendi i tij në vitin 1940 kur ishte 25 vjeç dhe zgjodhi të jetonte në Taizé, një fshat i vogël në Burgundy të Francës ku promovoi nisma për të ndihmuar dhe ofruar mikpritje për refugjatët dhe të përndjekurit.

Pas disa vitesh themeloi një komunitet të krishterë ndërftuar monastic, i cili ishte ndërkombëtar në qasje, një bashkësi paqeje dhe shërimi nga përçarjet midis besimtarëve të krishterë dhe jo vetëm.

5



FRÈRE ROGER SCHUTZ

.....
*Shpirti
që na bën
vëllezër*

SË BASHKU MUNDEMI

YAPS: rroftë bashkëpunimi

Yaps është një kompani e themeluar mbi njëzet vjet më parë nga disa institucione ndër të cilat edhe Fondacioni ynë. Yaps merret veçanërisht me shërbime pastrimi, të cilat sot i ofron në ambiente të ndryshme: banka, përfaqësi diplomatike, zyra dhe dyqane. Edhe Universiteti ZKM dhe Spitali Katolik kanë patur gjithmonë Yaps si kompaninë që i ka ofruar shërbimet e pastrimit. Aktualisht në këtë veprimtari pranë strukturave tona janë të angazhuar 25 persona, të cilëve u shtohen edhe të tjerë në raste të veçanta dhe të jashtëzakonshme. Edhe atyre me rastin e Krishtlindjes Fondacioni u ka dhuruar kartën e shëndetit për të përfutur shërbime pranë Spitalit Katolik.





SHËNDETI NJË E MIRË E PËRBASHKËT

Sigurim
shëndetësor
për stafin e
Fondacionit

Shëndeti është një e mirë e përbashkët. Dhe ky nuk është thjesht një slogan që përdoret nëpër konferenca apo fushata reklamuese. Fondacioni "Zoja e Këshillit të Mirë" i vetëdijshëm për vlerën e shëndetit të çdo punonjësi të tij në Shqipëri ka dashur t'i dhurojë me rastin e Krishtlindjes secilit prej tyre një dhuratë të veçantë: sigurimin shëndetësor për një vit. Punonjësit morën një kartë të personalizuar me emrin dhe mbiemrin e tyre nga kompania Albsig, shoqëria e sigurimit që është përzgjedhur për këtë nismë pas një procedure përzgjedhjeje të kryer nga ekspertë të jashtëm.

Me këtë kartë ata do të mund t'i drejtohen Spitalit Katolik të Tiranës për të përfituar shërbime shëndetësore falas, nga analizat laboratorike deri te shtrimi spitalor.

Edhe studentët e Universitetit Katolik me një kosto të përballeshme do të mund të nënshkruajnë pranë Albsig këtë ofertë shërbimesh. Studentët indianë kanë qenë të parët që kanë shfrytëzuar këtë mundësi të çmuar. Domethënia sociale e një nisme të tillë del qartë në situatën e pasigurisë në të cilën ndodhet ende sistemi shëndetësor shqiptar me pasoja të rënda për jetën e qytetarëve.



NËSE DO PAQE, PËRGATITU

CESPIC: Një Çmim i Ri nga Fondacioni

Komisioni i ngarkuar për dhënien e Çmimit të Paqes 2025, i promovuar nga Fondacioni ZKM nëpërmjet CESPIC (Qendra Europiane e Shkencës për Paqe, Integritet dhe Bashkëpunim), është mbledhur në dy seanca për të shqyrtuar propozimet e marra. Në edicionin e parë të Çmimit është dhënë mendimi për të vlerësuar dy subjekte: nga njëra anë një person fizik që ka treguar një angazhim të rëndësishëm humanitar të drejtpërdrejtë, dhe nga ana tjetër një institucion që ka dëshmuar një qasje origjinale ndaj çështjeve të dialogut dhe kulturës. Janë përzgjedhur në këtë mënyrë figura e Nihad Suljić dhe Projekti Joint History Books.

Në numrin e ardhshëm të ZKM Albania do të komunikohen detaje të tjera mbi fituesit e këtij çmimi, vendin dhe datën e ceremonisë së dhënies së çmimit. Dhënia e Çmimit vjetor për Paqen, së bashku me zgjedhjen e të Drejtës 2026 përbëjnë dy rrethana të rëndësishme të pjesëmarrjes aktive për të gjithë ata që në formë të ndryshme janë pjesë e Kampusit të Fondacionit ZKM në Tiranë. Përmes këtyre dy iniciativave synohet t'u jepet rëndësi përvojave domethënëse të paqes, dialogut, drejtësisë dhe bashkëjetesës civile, duke njohur në radhë të parë rolin e atyre që janë angazhuar. Në këtë mënyrë dalin në pah profile burrash dhe grash nga e kaluara e afërt, por edhe histori aktuale që përbëjnë një himn për jetën, për luftën për të mirën dhe për guximin e të dëshmuarit.



NJË NISMË E RE

Konferenca si të përdorim suplementet

Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” është partner në projektin kërkimor me titull “Integratorët




dhe Nutraceutikët në Aktivitet Fizik dhe Sport: deficiencat, përdorimi, tregtimi dhe njohja e tyre nga komuniteti i sportit në vendin tonë”, i financuar nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI). Në kuadër të këtij projekti, Prof. Asc. Silvi Bozo dhe Prof. Asc. Eftiola Pojani, nga Departamenti i Teknologjive Kimiko-Farmaceutike dhe Biomolekulare,

Fakulteti i Farmacisë, pjesë e grupit kërkimor, prezantuan rezultatet shkencore në Konferencën Shkencore “Suplementet dhe Nutraceutikët në Aktivitet Fizik dhe Sport: përdorimi, njohja dhe ndërgjegjësimi i komunitetit fizikisht aktiv për efektet e përdorimit të tyre” e zhvilluar më 11 dhjetor 2025 në ambientet e Hotel Mondial në Tiranë.

Konferenca përfaqëson një nismë inovative dhe të rëndësishme në rang kombëtar, të mbështetur mbi kërkim shkencor, duke bashkuar akademikë dhe profesionistë të fushave të sportit, shëndetit dhe mjekësisë. Projekti synon të kontribuojë në formulimin e rekomandimeve të bazuara në evidencë shkencore për përdorimin e sigurt, të informuar dhe të përshtatshëm të suplementeve në kontekstin e aktivitetit fizik dhe sportit, si dhe të mbështesë zhvillimin e praktikave dhe politikave më të mira në këtë fushë.

Kjo pjesëmarrje dëshmon angazhimin e vazhdueshëm të Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” dhe të stafit të tij akademik në kërkimin shkencor dhe bashkëpunimin ndërinstitucional në shërbim të shëndetit dhe performancës fizike.



ÇËSHTJE TË REJA NA SFIDOJNË

nga Luigino Bruni

**Doktrina
Sociale
e Kishës**

Ekonomia, drejtësia, kapitali, puna, paqja, sipërmarrjet nuk janë çështje të huaja në mendimet dhe mësimet e Kishës, por janë në zemër të shpalljes së lajmit të mirë të Ungjillit në botë. Nuk ka Kishë pa doktrinë shoqërore, nuk ka Ungjill që të mos flasë edhe gjuhën e ekonomisë. Sepse kështu ka qenë që nga fillimi.

Jezusi fliste për ekonominë: Ungjijtë janë plot me monedha, tregtarë, paga, punëtorë dhe taksa. Nuk ka Ungjill, nuk ka Kishë, që të mos merret edhe me çështjet ekonomike. Ekonomia nuk është një fushë vetëm për specialistët: ekonomia ka të bëjë me jetën dhe si rrjedhojë ka të bëjë me Kishën, me gjithë të krishterët. Ajo ka të bëjë me drejtësinë, pasurinë dhe varfërinë, paqen, cilësinë e marrëdhënieve tona dhe të ëndrrave tona, të tashmen dhe të ardhmen e të rinjve; prandaj ka të bëjë dhe duhet të ketë të bëjë me Kishën, me mendimin e saj, me veprimtarinë e saj, me inteligjencën e saj. Ajo ka të bëjë gjithashtu me Kishën në përgjigjet konkrete të atyre pyetjeve që kërkohen sot në histori, të cilat do të ndryshojnë nesër: ato quhen puna dhe inteligjencia artificiale, çështjet e mëdha të tranzicionit ekologjik, borxhet dhe kreditë ekologjike e financiare, si dhe akoma varfëria e të gjithëve, varfëria dhe uria e fëmijëve. Sot duke parë këtë botë të globalizuar duhet të pranojmë se ndërkohë që Kisha luftonte kundër komunizmit, kapitalizmi nga ana tjetër u rrit pa asnjë shqetësim dhe mes shpërqendrimit tonë u fut brenda mureve tona përmes Kalit të Trojës të shpallur prej tyre si “shpirt i krishterë”. Dhe kur në fund të shekullit të XX, qendra e kapitalizmit u zhvendos nga fabrika në financë dhe nga puna në konsum, fryma e biznesit pushtoi botën dhe shpirtat.

Nëse sot Kisha has vështirësi të mëdha në shpalljen e Ungjillit të Jezusit dhe ta bëjë atë të kuptueshëm, një arsye e thellë qëndron edhe në zbrazëtinë shpirtërore të shkaktuar nga nihilizmi i mallrave. Një kapitalizëm i shekullit XXI që është shndërruar në një fe duke zëvendësuar Krishterimin me dogmat e tij të meritokracisë dhe të lidërshiptit. Kritika e Ungjillit ndaj realiteteve të reja në ekonomi dhe në shoqëri sot nuk mund të mos jetë edhe një kritikë e qartë dhe e drejtpërdrejtë ndaj këtij kapitalizmi të ri që është shndërruar në fe.

IDENTITETI BASHKËKOHOR DHE POLITIKA

Konferenca e Ekonomisë në UKZKM

Konferenca e **22 Janarit**, e organizuar nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale, synon të shqyrtojë dinamikat bashkëkohore lidhur me politically correct dhe cancel culture, me vëmendje të veçantë mbi ndikimin e tyre në ndërtimin e identitetit individual dhe kolektiv. Në veçanti, konferenca do të analizojë fuqinë e



simboleve dhe identitetit në skenarin global të ndryshuar, mes erërave të luftës dhe përpjekjeve për dialog.

Roli i të drejtave themelore, të kristalizuar në simbole dhe veprimet e administratave publike në Europë, do të vlerësohet në dritën e historisë.

Elemente të këtij skenari janë praktikatat gjuhësore përfshirëse dhe ndjeshmëria në rritje ndaj grupeve të marginalizuara, të cilat favorizojnë forma të reja njohjeje, por njëkohësisht ngjallin

frikë nga censura dhe ngurtësimi i debatit publik. Analiza do të përqendrohet tek zhvillimet normative aktuale dhe të mundshme: nga rregulloret mbi gjuhën diskriminuese të politikave institucionale për mbrojtjen e dinjitetit dhe reputacionit, deri tek rreziqet e tej-rregullimit që mund të kufizojë lirinë e shprehjes.

U shkicua gjithashtu një seri skenarësh të mundshëm të së ardhmes, që luhaten midis formalizimit të mëtejshëm të mbrojtjeve dhe nevojës për të ruajtur hapësira të hapura diskutimi. Qëllimi është të ofrohet



një çelës leximi kritik për orientim në një panoramë në transformim të shpejtë, ku identiteti, rregullat dhe diskursi publik ripërcaktohen reciprokisht.

ARKITEKTURA VIZITA NË NJË KANTIER

Jo
vetëm në
auditorë



Studentët e vitit të parë të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara pranë UKZKM vizituan si pjesë e praktikës mësimore kantierin "Tirana Towers" ku po zhvillohet projekti i një kulle rezidenciale në Tiranë. Vizita mësimore ishte pjesë e lëndës "Materialet dhe Elementet e Ndërtimit të Arkitekturës"

dhe qëllimi i vizitës ishte njohja me kalimin nga projekti në ndërtim tek pilotimi i terrenit, themelet, strukturat prej betoni të armuar; përgatitja e armaturës prej çeliku dhe realizimi i një maketi studimor në shkallën 1:1.

Studentët shoqëroheshin në këtë praktikë nga lektori PhD Ark. Junik Balisha. Kjo nuk është hera e parë që studentët e Arkitekturës në UKZKM ndjekin vizita të tilla studimore që pasurojnë aftësitë e tyre profesionale dhe i rrisin shanset e të qenurit burimet më të kualifikuara njerëzore në fushat e tyre në të ardhmen.

NE I MOTIVOJME TË RINJTË PËR TË ARDHMEN

Diplomat si
pikënisje në jetë



Diplomimi është sukses i merituar i studentëve që kapërcejnë pragun e hyrjes në jetën profesionale. Kështu ndodh edhe me studentët tanë në UKZKM që garojnë me sukses në fusha të ndryshme profesionale duke patur në duar një diplomë ndërkombëtare si ajo e UNIZKM.

Por çfarë na dallon në universitetin tonin tonë është kujdesi për të motivuar edhe pas diplomimit të rinjtë që kanë lënë mbresa me tezat e tyre të diplomave. Një moment të tillë e ndajmë edhe me publikun duke treguar me krenari ngjarjen që bashkoi 11 të rinjtë që shkëlqyen me tezat e tyre ndërsa vunë në kokë

kurorat me dafina. Tezat më të mira u duatrokitën nga komisioni i vlerësimit pranë Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" në sallën e re të Casa Rosa ku dhanë përshëndetjet dhe inkurajimet Rectori i UKZKM Prof. Leonardo Palombi, Presidenti i FZKM fr. Ruggero Valentini, ndërsa vetë të diplomuarit paraqitën përmbledhje domethënëse nga puna e tyre kërkimore. Në përfundim të ceremonisë të diplomuarit u nderuan me çmimin simbolik të vlerësimit që iu dorëzua nga autoritetet drejtuese të UKZKM dhe Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë.

JO VETËM "IKJE E TRURIT"

Të diplomuarit
e UNIZKM në botë

Emigrimi i profesionistëve të rinj zakonisht përshkruhet me shprehjen "ikje e trurit". Shumë vende përballen me këtë situatë, e cila prek veçanërisht Ballkanin, Evropën Lindore por edhe shtete të tjera si Italia. Sa i përket Shqipërisë ky fenomen tashmë është bërë kronik dhe nuk duket se po zvogëlohet. Megjithatë shihen disa shenja ndryshimi si rikthimi i një numri të konsiderueshëm profesionistësh shqiptarë pas përfundimit të programeve të specializimit dhe eksperiencave të punës jashtë vendit.

Gjatë takimit të fundit të "Alumni" më 18 dhjetor 2025 në UKZKM u perceptua qartë ky trend, i cili mund të sjellë një përfitim të madh për Shqipërinë nëse inkurajohet më shumë. Duket qartë se këta të rinj kthehen në vendin e tyre vetëm nëse gjejnë mundësi domethënëse dhe konkrete për të realizuar ëndrrat e tyre dhe për të aplikuar kompetencat dhe aftësitë e fituara. Gjatë takimit ish-studentët ndanë përvojat e tyre të punës në Shqipëri duke arritur një standard të lartë të cilësisë profesionale. Prezantimet prekën fusha të ndryshme të jetës: shëndetësinë, ekonominë dhe arkitekturën, të cilat janë tre programet kryesore të studimit të ofruara nga Universiteti ZKM dhe që përbëjnë hapësirat kryesore të nevojave, të kujdesit dhe të krijimtarisë në jetën sociale.

Kontakt dhe informacion: info@unizkm.al





PËRBALLIMI I EMERGJENCËS ARSIMORE

Shkollat Katolike: rrjeti më i madh arsimor në botë

Rrjeti arsimor katolik është një nga rrjetet më të përhapura në botë me një ndikim që shkon shumë përtej botës katolike.

Në rajonet me të ardhura të ulëta rrjeti arsimor katolik shpesh përbën alternativën e vetme të strukturuar dhe të qëndrueshme. Sot gati gjysma e nxënësve të shkollave katolike në botë ndodhen në Afrikë (43%), e ndjekur nga Azia (21%), Amerika (20%) dhe Europa (14%). Por nevojat janë të ndryshme: nëse në Azi dhe Afrikë sfidat lidhen me infrastrukturën dhe aksesin, në Europë çështja kryesore është fragmentimi dhe qëndrueshmëria e shkollave të vogla. Sidoqoftë nevojitet vizion, mjete dhe aleanca.

Pas përqindjeve gjenden fytyra dhe histori. Shifrat nuk janë një fotografi statike, por një hartë në lëvizje: ato tregojnë ku rritet kërkesa, ku oferta është e dobët, ku arsimi mund të vazhdojë të jetë një mjet drejt drejtësisë sociale. Pika kritike është se më shumë se 160 milionë adoleshentë në botë mbeten jashtë arsimit të mesëm. Për shumë prej tyre sidomos në kontekste të marginalizuara urbane dhe rurale, shkollat katolike janë të vetmet që ofrojnë vazhdimësi. Por thjesht hapja e shkollës nuk mjafton.

Duhet të krijohen kushtet që nxënësit të qëndrojnë. Dhe kjo do të thotë transport, bursa studimi, siguri, orientim, lidhje me komunitetin. Nuk është një detaj që në shumë vende numri i regjistrimeve tejkalon përqindjen e popullsisë katolike. Është një shenjë e një shkolle të perceptuar si hapësirë besimi, përfshirjeje dhe cilësie. Mjafton të marrim parasysh numrin e madh të shkollave katolike

në Indi ku katolikët përbëjnë vetëm 1,7% të popullsisë. Dallohen tre modele kryesore: vendet ku shkollat katolike janë shumicë (Belgjikë, Ruanda), kontekstet ku ekzistojnë partneritete të strukturuar publike-private

dhe situatat ku prania katolike është pakicë por domethënëse dhe shpesh inovative. Në të tre rastet sfida është e njëjtë: të shmanget mbyllja në vetvete dhe të rigjenerohen rrjetet arsimore të rrënosura në komunitetet lokale. Këtu arsimit luan rolin e tij social. Këtu vizioni kishtar i edukimit si akt koral, komunitar dhe gjenerativ tregon fuqinë e tij. Së fundmi është lançuar Atlasi Interaktiv i Arsimit Katolik, një mjet digjital dhe dinamik i promovuar nga Observatori

Ndërkombëtar i projektuar për të ofruar të dhëna në kohë reale, tregues të vulnerabilitetit, si dhe harta të nevojave dhe potencialeve.

Ky projekt bashkon dimensionin pastoral dhe aftësinë menaxheriale, inteligjencën lokale dhe vizionin global. Sepse arsimi sot më shumë se kurrë kërkon perspektiva afatgjata, mjete fleksibël dhe vendime të bazuara mirë. Të dhënat nuk përdoren për të lënë mbresa, por për të orientuar: janë harta që ndihmojnë të zgjedhësh, të kuptosh ku nevojiten më shumë burime, më shumë vëmendje, më shumë guxim.

“Rrjeti katolik është rrjeti më i madh arsimor në botë”. Këtë e theksoi Elena Beccalli Rektore e Universitetit Katolik “Sacro Cuore” dhe presidente e Federatës së Universiteteve Katolike Europiane (FUCE), e cila në vitin 2022 zhvilloi asamblenë e saj në Tiranë në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”.

231 mijë institucione arsimore në 171 vende

71,9 milionë studentë, prej të cilëve 43% në Afrikë

Rreth 5 milionë studentë frekuentojnë Universitete katolike

61 milionë fëmijë mbeten jashtë arsimit fillor

160 milionë adoleshentë mbeten jashtë arsimit të mesëm

SHKOLLAT KATOLIKE NË SHQIPËRI

“Në një epokë të shënuar nga polarizime të thella dhe pabarazi në rritje arsimi mund të jetë një nga mjetet më efektive dhe transformuese për të nxitur zhvillimin njerëzor në nivel global”.


Kjo është teza e Rektorit Beccalli, e cila ka ngritur alarmin se në botë 61 milionë fëmijë nuk kanë hyrë kurrë në një klasë që do të thotë fëmijë pa asnjë akses në arsim. Për më tepër mbi 160 milionë të rinj nuk e përfundojnë arsimin e mesëm një shifër që tregon se sa shumë braktisja e shkollës përfaqëson ende një plagë shoqërore në nivel global”. Prej këtui lind nevoja për “të garantuar të drejtën universale për arsimim, e cila edhe sot nuk është plotësisht e siguruar përmes “një veprimtarie të përbashkët” të universiteteve katolike. Një mesazh i qartë, edhe për Universitetin tonë.



ARSIMI KATOLIK PARAUNIVERSITAR NË SHQIPËRI 2024 – 2025

Dioqezat e pranishme në Shqipëri, përmes institucioneve fetare, ofrojnë një sistem të strukturuar të arsimit publik parauniversitar, që përfshin shërbime arsimore nga fëmijëria deri në gjimnaz. Shpërndarja territoriale e ofertës lidhet ngushtë me përbërjen e popullatës katolike dhe me flukset migratore të brendshme, veçanërisht drejt Tiranës. Analiza tregon një dominim të kopshteve dhe institucioneve të arsimit bazë, ndërsa arsimi profesional është më i kufizuar dhe i përqendruar territorialisht. Institucionet zakonisht specializohen në lloje të caktuara shërbimesh, megjithatë disa struktura ofrojnë programe më të gjera arsimore, si Instituti Don Bosko në Tiranë. Arsimi katolik parauniversitar ka natyrë publike dhe gjithëpërfshirëse, duke u drejtuar ndaj gjithë popullatës lokale pa marrë parasysh përkatësinë fetare. Ky orientim konfirmohet nga përbërja e popullatës së studentëve, ku rreth 41% e studentëve nuk i përkasin besimit katolik, me variacione në përputhje me karakteristikat demografike të çdo dioqeze.

Appartenenza religiosa degli studenti



Numero e tipologia del servizio



Sa i përket cilësisë së ofertës arsimore, përveç perceptimit të gjerë pozitiv nga ana e popullsisë shqiptare, mund të identifikohet një tregues objektiv që paraqitet nga raporti mësues/student. Në arsimin katolik parauniversitar, ky raport është mesatarisht 1:10, një vlerë dukshëm më e favorshme krahasuar me standardin që zakonisht vërehet në sistemin arsimor, rreth 1:20. Përbërja gjinore e studentëve është kryesisht e balancuar, megjithatë vërehet një dominim i moderuar i meshkujve (53%). Paralelisht, numri i studentëve me aftësi të kufizuara duket jashtëzakonisht i vogël (më pak se 1%), një e dhënë që merr rëndësi të veçantë (dhe në të ardhmen do të kërkojë më shumë vëmendje) në lidhje me politikat e përfshirjes, nivelin e aksesueshmërisë së infrastrukturave arsimore dhe planifikimin e ardhshëm të shërbimeve mbështetëse dhe shoqëruese.

HAPËSIRË E VOGËL
PROMOVUESE

Një hap larg shëndetit tënd!
Kartë Shëndeti për Studentët e Universitetit Katolik
“Zoja e Këshillit të Mirë” me ULJE TË DEDIKUARA
 në shërbimet mjekesore të **Spitalit Katolik Zoja e Këshillit të Mirë**.

UNIVERSITETI KATOLIK
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

Spitali Katolik
Zoja e Këshillit të Mirë
Përkushtuar Shëndetit Tënd



KTHIM NË TË ARDHMEN

Fratel Natalino: misioni vazhdon

Pas dymbëdhjetë vitesh në Shqipëri **fr. Natalino Poggi** ka përfunduar misionin e tij në Tokën e Shqiponjave dhe është kthyer në Itali. Ai nis një mision të ri të së mirës në përputhje me thirrjen e tij si njeri i kushtuar Zotit.

Në vitet e fundit së pari si drejtor administrativ dhe më pas si drejtor i përgjithshëm ai kontribuoi në themelimin dhe zhvillimin e Spitalit Katolik. Më parë ai kishte drejtuar aktivitetet e Poliambulancës "Atë Monti" në Rugën e Kavajës, të Klinikës së Stomatologjisë dhe të Qendrës së Fizioterapisë.

Pas ardhjes në Tiranë me një përvojë të rëndësishme në fushën arsimore dhe shëndetësore fr. Poggi që në fillim i dha impuls Poliambulancës, e cila ishte funksionale që nga viti 1995 dhe kishte nevojë për një rinovim.

Fondacioni dëshiron të shprehë një falenderim të përzemërt për shërbimin e tij bujar gjatë këtyre viteve me përkushtim dhe kompetencë për një shëndetësi moderne dhe etike. Fr. Natalino ka bërë pjesën e vet që Fondacioni të shprehë më së miri natyrën e tij si ent jo-fitimprurës i frymëzuar nga krishterimi dhe i rrënjësuar mirë në realitetin shqiptar. Presidenti fr. Ruggero Valentini shprehu dëshirën që "largimi i tij të mos lërë një boshllëk, por përkundrazi të jetë më i frytshëm për thirrje të tjera, të përkushtuara ndaj Ungjillit të dashurisë që Jezusi na e la si rregull jete".

Kjo ftesë u drejtohet figurave të shumta profesionale që tashmë japin kontributin e tyre në misionin e Fondacionit si dhe studentëve të rinj të Universitetit në mënyrë që formimi i tyre profesional të shfaqet si një thirrje e pasur me dimension shpirtëror dhe përkushtim social.



Nga e djathta, Fr. Natalino Poggi, Fabjan Cenko me Presidentin e Republikës së Shqipërisë Bajram Begaj gjatë vizitës në Spitalin Zkm.



P.A.S.S.I. DHE BASHKËPUNIMIT BILATERAL

**Provincia
Autonoma
e Trentos
(Itali)**



Projekti për të cilin duam të flasim përbën një model operativ të bashkëpunimit ndërkombëtar të suksesshëm ku të dy palët protagoniste përfshihen me respekt për dinjitetin e tyre dhe në bazë të reciprocitetit të shkëmbimit. Projekti quhet P.A.S.S.I.

(Projekti i **Provincës Autonome të Trentos për Asistencën Sociale-Shëndetësore Ndërkombëtare** – Një rrugëtim edukativ në Ballkan dhe në Trentino për operatorët e rinj shëndetësorë).

Ndër objektivat e projektit janë:

- Plotësimi i **kurrikulës formuese** të studentëve që diplomohen në Shkencat
- Infermieristike në Universitetin "Zoja

e Këshillit të Mirë” në Tiranë përmes realizimit të praktikave profesionale.

- Krijimi i një **shërbimi falas të shërbimit shëndetësor** screening për zonat më të marginalizuara të Republikës së Shqipërisë me qëllim nxitjen e diagnostikimit të hershëm të sëmundjeve onkologjike dhe përmirësimit të aksesit në kujdesin parësor shëndetësor.

Për këto aktivitete janë të përfshira Fondacioni ZKM i Tiranës përmes Universitetit dhe Spitalit të tij si dhe kooperativat sociale të Trentinos VALES dhe SPES, të cilat menaxhojnë struktura socio-shëndetësore dhe asistenciale.

Projekti parashikon edhe dy objektiva të tjerë:

- Forcimi i shkollës profesionale San Giuseppe në **Brëshen** përmes ofrimit të kurseve të gjuhës italiane dhe mbështetjes për studentët që vijnë nga kontekste të marginalizuara.
- Studim i fizibilitetit për ndërtimin e një Residence Shëndetësore-Kujdestare për të moshuarit në Shqipëri.

Projekti synon të kapitalizojë marrëdhëniet e ndërtuara me kohë midis aktorëve publikë dhe privatë që veprojnë në Shqipëri dhe të krijojë një ekosistem partneriteti Trento-Shqipëri. Ai promovon një qasje të bashkëpunimit të decentralizuar dhe të barabartë duke nxitur dialogun midis sistemeve të Trentos dhe Shqipërisë. Projekti ka një kohëzgjatje trevjeçare me një angazhim ekonomik prej rreth 150 mijë eurosh në vit.



DIMENSIONI I BRENDSHËM I PROFESIONIT

Mjekësia si një thirrje



Shtëpia botuese ZKM Press ka publikuar punimet e një konference të mbajtur në Universitetin Katolik me temë: “Thirrja në mjekësi”, e cila lindi nga kërkimet për tezën e diplomës së **Dr. Stiven Shala** nën udhëheqjen akademike të prof. Francesco Rulli. Më poshtë publikojmë parathënien e vëllimit, i cili gjendet në Bibliotekën e Universitetit (176 faqe, në italisht dhe anglisht, 10 €).

Nga ky punim po zhvillohet një veprimtari shumë e strukturuar për të cilën do të sjellim njoftime në vijim. Tema mbi thirrjen në mjekësi e shoqëron mjekësinë që nga fillimet e saj. Hyrja në këtë profesion nuk ka nënkuptuar thjesht zotërimin e njohurive teknike apo ushtrimin e një zanati, ajo ka përfshirë gjithmonë diçka më të thellë: një thirrje për shërbim, për lehtësimin e vuajtjes dhe për vënien e kompetencave në shërbim të dinjitetit njerëzor.

Në një epokë ku praktika mjekësore karakterizohet nga një inovacion i shpejtë teknologjik nga kërkesa të ndërlikuara organizative dhe nga një rrezik në rritje i lodhjes profesionale, rikujtimi i kësaj thirrjeje bëhet jo vetëm aktual, por edhe i domosdoshëm. Ky vëllim e ka zanafillën në një kërkim shkencor. Në fakt, studimi

empirik midis studentëve të mjekësisë përbën boshtin qendror të punës. Me qartësi dhe rigorozitet, Dr. Shala ka shqyrtuar se çfarë i motivon të rinjtë që të përqafojnë mjekësinë si zhvillohet ose ndryshon ndjenja e tyre lidhur me këtë thirrje gjatë studimeve, si dhe pengesat që hasin në kalimin nga entuziazmi fillestar drejt kërkesave të përditshme të jetës akademike dhe klinike. Rezultatet ofrojnë një panoramë të gjallë të një brezi në formim e sipër.

Ato zbulojnë aspirata dhe dyshime, peshën e sfidave dhe forcën e qëndrueshmërisë. Po ashtu, ato kujtojnë se thirrja nuk është kurrë një gjendje statike, por një realitet që mund të piqet, të dobësohet ose të rrezikojë të humbasë në varësi të kontekstit, të udhëzimit të marrë dhe të prirjes personale. Ky studim mbledh kontribute nga zëra pastoralë, pedagogë dhe profesionistë.

Reflektimet historike dhe teologjike rikujtojnë mënyrën se si ideja e thirrjes në mjekësi është interpretuar përgjatë shekujve. Idetë pedagogjike shtrojnë pyetjen se si mësuesit mund të zgjojnë dhe të mbështesin ndjenjën e kësaj thirrjeje tek studentët e tyre. Dëshmitë profesionale tregojnë se si kjo thirrje shpaloset përgjatë



harkut të një jete në mjekësi, me momentet e saj të gëzimit dhe të përmbushjes, por edhe të lodhjes dhe të krizës. Kur kombinohen këto perspektiva krijojnë një dialog të vërtetë: midis të dhënave dhe përvojës, midis zërave të studentëve dhe atyre të mentorëve, midis saktësisë së analizës shkencore dhe thellësisë së reflektimit njerëzor. Rezultati është një kontribut që i drejtohet njëkohësisht kërkimit akademik edhe zhvillimit personal duke ofruar orientim për ata që dëshirojnë të kuptojnë më mirë motivimet dhe sfidat e studentëve të mjekësisë së sotme.

Në të njëjtën kohë, këto reflektime shtrihen përtej kufijve të formimit mjekësor.

Ato prekin kërkimin e njeriut për kuptim, si edhe tensionin e vazhdueshëm midis idealeve dhe realitetit, midis shërbimit dhe përgjegjësisë. Ato na kujtojnë se thirrja nuk është kurrë një zotërim individual, por një përgjegjësi e ndarë me të tjerët, e mbështetur nga komuniteti dhe kultura. Rikujtimi i thirrjes në mjekësi do të thotë të rikujtohet lidhjen midis dijes dhe shërbimit, midis kompetencës dhe dhembshurisë, midis shkencës dhe njerëzores.

Pikërisht në këtë rikujtim qëndron vlera e vërtetë e këtyre faqeve, një ftesë jo vetëm për ta kuptuar më qartë thirrjen, por edhe për ta jetuar atë më plotësisht, në mjekësi dhe përtej saj.

DREJT NJË QENDRE REFERIMI NË SHQIPËRI

Zgjerimi i Shërbimeve
të Rehabilitimit


Qendra e Rehabilitimit e themeluar në vitin 2005 nga Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë (FZKM) është gati të ndërmarrë një hap të mëtejshëm zhvillimi falë një projekti të financuar së fundmi, i cili do të zbatohet në muajt e ardhshëm.

Qëllimi është të përmirësohen ndjeshëm shërbimet e rehabilitimit veçanërisht në fushën e rehabilitimit neurologjik.

Projekti i financuar me fondet e Kishës Katolike Italiane dhe me miratimin e Konferencës Episkopale Italiane (CEI) (Projekti Nr. 238/2025) synon ta bëjë Qendrën një pikë referimi në nivel kombëtar për trajtimin e patologjive neurologjike komplekse, si skleroza multiple, sëmundja e Parkinsonit, dëmtimet e palcës kurrizore dhe sëmundje të tjera degjenerative dhe neurodegenerative.


Melokacion në Laprakë, Tiranë, brenda Kompleksit Spitalor Universitar "Zoja e Këshillit të Mirë" kjo Qendër disponon një strukturë moderne prej 1.100 m² që përfshin ambiente funksionale, palestër rehabilituese dhe pishinën e vetme terapeutike për rehabilitim me ujë në Shqipëri. Çdo vit qendra ofron rreth 6.000 shërbime rehabilitimi dhe luan një rol kyç në formimin universitar të fizioterapistëve në bashkëpunim me Universitetin e Romës "Tor Vergata".

Projekti është plotësisht në përputhje me misionin e frymëzuar nga karizma e të Lumit Luigji Monti themelues i Kongregatës së Bijve të Zojës të Papërlyer (CFIC) duke promovuar një kujdes gjithëpërfshirës për personin (fizik, psikologjik dhe shpirtëror) dhe duke parë te të sëmurët praninë e gjallë të Krishtit.



Në muajt e ardhshëm falë këtij financimi do të prezantohen tre teknologji të reja që do të forcojnë kapacitetet diagnostikuese dhe terapeutike të Qendrës si mjet për ngritjen e pacientit, një pajisje kyçe për ngritjen dhe transferimin e sigurt të pacientëve me lëvizshmëri të kufizuar.

Kjo do të sjellë më shumë autonomi për pacientët dhe ul rreziqet për personelin. Instalimi do të jetë i plotë dhe do të përfshijë gjithashtu trajnimin e stafit dhe planin e mirëmbajtjes.



Vala goditëse

Kjo është një pajisje për trajtimin e çrregullimeve muskulo-skeletore dhe për rigjenerimin e indeve. Aplikimet e saj përfshijnë edhe trajtimet në fushën urologjike. Projekti parashikon instalimin, konfigurimin, trajnimin e operatorëve dhe asistencën teknike.

Tigo Cikloergometër: është një instrument i projektuar për rehabilitimin neuromotor dhe stërvitjen muskulore.

Do të përdoret për të mbështetur pacientët në programe të personalizuar rikuperimi funksional. Edhe në këtë rast parashikohen të gjitha fazat operative: përgatitja e ambientit, instalimi, trajnimi dhe mirëmbajtja. Përmes këtij projekti Qendra e Rehabilitimit në UKZKM do të konsolidojë më tej rolin e saj në panoramën shëndetësore shqiptare duke forcuar cilësinë e shërbimeve të ofruara dhe duke kontribuar në zhvillimin profesional të stafit mjekësor dhe në mirëqenien e përgjithshme të komunitetit.

PARANDALIMI I INTEGRUAR KARDIO-RENO-METABOLIK MODELI I SË ARDHMES

Një dialog shkencor ndërkombëtar mbi parandalimin e së ardhmes

Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" organizoi ngjarjen shkencore me temë "The Cardio Kidney Metabolic Syndrome – A new model for longitudinal Prevention" më datë 13 janar 2026 në "Aula Magna". Nisma u promovua dhe organizua nga Rektori i UKZKM Prof. Leonardo Palombi dhe synon të nxisë në vijim një diskutim shkencor ndërdisiplinor mbi modelet e reja të parandalimit longitudinal në fushën kardio-renale-metabolike, me kontributin e akademikëve dhe klinikistëve me famë ndërkombëtare, ndër të cilët edhe Prof. Massimo Federici.

Eventi iu adresua pedagogëve universitarë, kërkuesve shkencorë, profesionistëve të shëndetësisë, spitaleve dhe fondacioneve që veprojnë në sektorin e shëndetit dhe parandalimit.



TË MBROJMË SHËNDETIN

Unaza e Mbretit Solomon:
energji, bashkëndarje dhe
shëndet

Që prej ditës kur u ndërtua "Unaza e Mbretit Solomon" është kthyer në një nga pikëtakimet më interesante dhe të frekuentuara të studentëve dhe jo vetëm në Kmapusin ZKM. Shpesh është e mbipopulluar gjatë fundjavës kur të apasionuarit pas vrapimit spontan, profesionist dhe amator përshkojnë kilometrat e pistës që rrethohet nga gjelbërimi dhe qetësia.

Çdo fundjavë kampusi "shplodhet" nga zhurma dhe gjallëria e jetës studentore dhe vendin e bisedave dhe gumëzhimave rinore e zënë vrapuesit tanë. Ata gjatë vitit 2025 kanë marrë pjesë në çdo ngjarje sportive, në çdo oragnizim profesional dhe në maratonat sfiduese duke dhënë shembullin e jetës së shëndetshme.

TAKIMET E ARDHSHME



FONDAZIONE
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO
Tirana
Dedicata all'educazione, dedicata alla salute

Celebriamo

20 anni
2005-2025

FACOLTÀ
DI FARMACIA

10:00

14:30

UN
ACCORDO
PER
IL FUTURO...

...tra Ospedale Cattolico
NSBC di Tirana
e Bambino Gesù di Roma

28 gennaio 2026

Università Cattolica
"Nostra Signora del Buon Consiglio", Tirana



UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

20 anni
2005-2025

FACOLTÀ DI FARMACIA

PROGRAMMA

- 10:00** **Saluti Istituzionali**
Fr. Ruggero Valentini
Presidente, Fondazione NSBC
Prof. Leonardo Palombi
 Rettore, Università Cattolica NSBC
Prof. Roberto Perrone
 Preside Facoltà di Farmacia di UCNSBC
- 10:30** **Saluti Autorità invitate**
On. Dr. Marcello Gemmato
 Sottosegretario di Stato alla Salute, Italia
S.E. Dr. Marco Alberti
 Ambasciatore d'Italia in Albania
Dr. Defrim Goma
 Presidente Ordine Farmacisti Albania
Dr. Davide Rogai
 Presidente Confindustria Albania
- 11:15** **Interventi di laureati in Farmacia della UCNSBC nel 1° ventennio**
- 12:00** **Inaugurazione dei laboratori di ricerca della Facoltà di Farmacia: Cerimonia taglio nastro e Benedizione dei laboratori, Presidi C. De Giuli Morghen e R. Perrone**
LABORATORIO di VIROLOGIA CELLULARE e MOLECOLARE
LABORATORIO di CHIMICA e ANALISI FARMACEUTICHE
LABORATORIO di TECNOLOGIA FARMACEUTICA
- 12:30** **Presentazione e omaggio del 1° prodotto di ricerca, realizzato nei nuovi laboratori di ricerca: prof. N. Denora, e prof. M. Leopoldo.**
- 13:00** **Buffet di convivialità**



Centro per lo sviluppo
del bambino

PROGRAMMA

13.00 **Buffet di accoglienza**

14.30 **Incontro in Aula Magna**

Saluto

Fr. Ruggero Valentini
Presidente, Fondazione NSBC

Prof. Leonardo Palombi
 Rettore, Università Cattolica NSBC

Prof. Tiziano Onesti
 Presidente Ospedale Pediatrico Bambino Gesù

Interventi

Prof.ssa Evis Sala
 Ministro della Sanità, Repubblica Albanese

On. Dr. Marcello Gemmato
 Sottosegretario di Stato alla Salute, Italia

Prof.ssa Anila Godo
 Preside, Facoltà di Medicina, Università Cattolica NSBC

Dott. Massimiliano Raponi
 Dott. Sandro Cristaldi

OPBG

16.00 **Firma dell'Accordo di collaborazione**
 Avvio della collaborazione tra i due Ospedali



In una giornata speciale la **Fondazione Nostra Signora del Buon Consiglio** invita a due momenti di grande rilevanza per il mondo accademico e sanitario.

L'anniversario della Facoltà di Farmacia dell'**Università Cattolica di Tirana** rappresenta vent'anni di impegno, dedizione e innovazione nella formazione e nella ricerca farmaceutica.

Un percorso di importanti collaborazioni, dapprima con l'**Università di Milano**, poi con l'**Università di Bari**. Abbiamo insieme formato generazioni di professionisti competenti, appassionati e pronti a contribuire in maniera significativa al progresso della scienza e della salute in Albania e non solo.

In concomitanza, viene sancita una nuova collaborazione tra **Ospedale Cattolico NSBC di Tirana** e **Ospedale Pediatrico Bambino Gesù di Roma**.

Questa partnership mira a rafforzare le iniziative nel settore pediatrico, promuovendo progetti innovativi, ricerca congiunta e scambio di esperienze, con l'obiettivo di migliorare continuamente l'assistenza ai piccoli pazienti e la formazione dei futuri professionisti.



Collaborano con noi

